

## STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### "PUBLIC BAR " SHPK

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "PUBLIC BAR" SHPK, me daten 10/07/2023 eshte themeluar nga ortaket:

- **Znj. Suzana Sharra**, shtetas SHQIPTARE, e datl. 13/04/1956, BERAT/Alb, mbajtes i ID , me nr.**F65413132D** , madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME/Neni 1**

Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejttat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit e te ketij statuti.

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE/Neni 2**

*Bar-Kafe Birrari,Ushqime i shpejte etj*

#### **SELIA E SHOQERISE/Neni 3**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "PUBLIC BAR" SHPK, ka seline e saj ne; *Rr.Njesia Bashkiake nr 5,Rruga Muhamet Gjollesha,Pallati me Zone Kadastarele 8270 nr Pasurie 1/357-N9* Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

#### **KOHEZGJATJA/Neni 4**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimit te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakeve te shoqerise.

#### **DETYRIMET E ORTAKEVE/Neni 5**

Ortaket e shoqerise duhet te kryeje depozitimin e kapitalit themeltar per llogari te shoqerise ne nje banke te caktuar prej tyre.

## **TRANSFERIMI I KUOTAVE/Neni 6**

Ortakët e shoqërisë mund të kalojnë pjesën nga kapitali themeltar i personave të tjerë në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 73 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## **PARAQITJA KONTABILE/Neni 7**

Operacionet e shoqërisë kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktësi në bilancin vjetor të aktivitetit.

Në mbyllje të çdo viti ortakët ose personi i ngarkuar prej tyre, bëjnë inventarizimin dhe llogariten vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe hartojnë raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar.

## **KAPITALI THEMELTAR/Neni 8**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (njëqindmijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si vijon :

Lloji i kontributit është në para në vlerën 100 000 (njëqindmijë) lekë, i ndarë në 1 kuota me vlerë 100.000 (njëqind mijë ) lekë kuota;

- **Znj. Suzana Sharra**, është zotëruar i 1 (një Kuote) me vlerë 100 000 Lek (njëqind mijë lek), që korrespondon në 100 % të Kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar tërësisht nga ortakët e shoqërisë.

## **OPERACIONET FINANCIARE**

### Neni 9

Shoqëria është e autorizuar për të siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve të kreditit ose atyre të financimeve totale apo të jashtme, institucioneve ndërkombëtare të financimit dhe të kreditit sido që të jete përcaktuar.

## **BLERJET E SHOQËRIVE**

### Neni 10

Shoqëria disponon mjetet e saj në përputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqërisë. Në Republikën e Shqipërisë, shoqëria gëzon të drejtën e saj për të zotëruar mjete të saj si në çdo shoqëri tjetër ose organizatë tregtare, kombëtare shqiptare në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

## FONDI REZERVE

### Neni 11

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e tij.

Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga ortaket ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te shoqerise raportohen ne bilance te shprehur ne leke shqiptare, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Bilanci dhe perlllogaritjet ekonomike te shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

## PLANET FINANCIARE

### Neni 12

Aktiviteti i shoqerise mbi bazen e programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin financiar te saj. Planet financiare parashikojne koston dhe te ardhurat e shprehura ne leke shiptare. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do te paraqiten ne leke shqiptare. Rezultatet financiare te aktivitetit dhe te punes se kryer nga shoqeria, paraqiten ne bilancin vjetor. Kursi i kembimit te monedhes shqiptare ne monedhat e huaja dhe e kunderta do te jene ato te vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

## ORGANET E SHOQERISE

### Neni 13

Organi vendimmarres i shoqerise "**Public Bar**" SHPK eshte asambleja e ortakeve e perbere nga ortaket e shoqerise. Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## **MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

### **Neni 14**

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## **MËNYRA E THIRRJES**

### **Neni 15**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik

ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS**

Neni 16

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 të statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

## **PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE**

Neni 17

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe

mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **KUORUMI**

### Neni 18

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **MARRJA E VENDIMEVE**

### Neni 19

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, për ndryshimin e statudit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

## **PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË**

### Neni 20

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## **ADMINISTRATORI**

Neni 21

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar administrohet nga nje ose disa persona fizike. Administratori i shoqerise emerohet me vendim te ortakut te shoqerise. Afati i qendrimit ne detyre i administratorit te shoqerise eshte per nje periudhe 5 (pese) vjecare.

- *Administrator i kesaj shoqerie eshte **Znj Suzana Sharra** shtetase SHQIPTARE, e datl. 13/04/1956 , lindur ne Berat, mbajtes i ID , me nr.F65413132D madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;*

Administratori i shoqerise i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe u njeh ligji shprehimisht Asamblese se Ortakeve ose te treteve.

Administratoret kane pergjegjesi ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkeljete ligjeve, statutit apo shkeljeve te kryera gjate administratimit. Administratori ne rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

## **RASTET E PUNES**

Neni 22

Raportet e punes ndermjet shoqerise, filialeve dhe agjensive te saj si dhe te punonjesve ne te, rregullohen ne baze te kontrates se punes, konform Kodit te Punes.

Per sa nuk parashikohet ne kontraten e punes, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 23

Shoqeria merr persiper, te shlyeje rregullisht te gjitha detyrimet e saj qe burojne nga legjislacioni per sigurimet shoqerore e shendetesore lidhur me te punesuarit e saj.

## **DERFUNDIMI I AKTIVITETIT**

Neni 24

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:

- 1.Me kalimin e afatit per kohezgjatjen e saj ne kontraten e themelimit.
- 2.Per pamundesine e realizimit te objektit te saj.
- 3.Me vendimin e gjykates.



## **LIKUJDIMI**

Neni 25

Likujdimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

## **KUSHTET E TJERA**


Neni 26

Te gjitha vendimet e mara nga asambleja e ortakeve evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e shoqerise.

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete, statut do ti referohen plotesimeve qe mund te bejne ortaket si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**THEMELUESIT**

**Znj.Suzana Sharra**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Suzana Sharra', written over a printed name.

**Tirane ,10/07/2023**